



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1555/2 Prot.

Tiranë, më 21.12.2021

V E N D I M

Nr. 251, Datë 21.12.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 207 Regj., datë 09.11.2021, të paraqitur nga I. K¹ kundër Drejtorisë së Kujdesit Social/Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë Bashkisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës²” dhe “gjendjes civile³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues, I. K në mes të tjerash informon se, është banorë e qytetit të Korçës, ka një fëmijë të moshës 4 vjeç, është kryefamiljare e vetme dhe i përket minoritetit rom. Ankuesja shprehet se në muajin gusht 2021 ka bërë regjistrimin e vajzës në kopsht. Në muajin nëntor ankueses i është kërkuar nga ana e kopshtit, të paguante tarifën e përcaktuar për regjistrimin e fëmijës në kopsht.

Në vijim të ankesës, znj. K ka pretenduar se fëmija e saj është diskriminuar, pikërisht për shkak të racës, pasi në kundërshtim me parashikimet ligjore të cilat ofrojnë mbrojtje dhe përjashtim nga pagesa e kësaj tarife për kategoritë e fëmijëve që janë anëtarë të minoritetit rom, i është kërkuar të realizojë këtë pagesë. Ajo shprehet se, nga informacionet që ka marrë është vënë në dijeni të faktit se, Bashkia ka fonde të veçanta për këto kategori, anëtarë të minoritetit rom, përse i takon mbulimit të kësaj pagese nga ky Insitucion.

Në këtë kontekst, në kushtet kur nga ana e kopshtit i është kërkuar të realizojë pagesën për fëmijën e vet, ankuesja i është drejtuar Drejtorisë së Kujdesit Social/Njësisë për Mbrojtjen e

¹ Për fëmijën e saj minoren N. L.

² Ankuesja është pjesëtare e minoritetit rom.

³ Referuar Certifikatës familjare, datë 08.11.2021 të Zyrës së Gjendjes Civile Korçë, ankuesja rezulton kryefamiljare dhe prind i vetëm për fëmijën N. L.

Fëmijëve, pranë Bashkisë Korçë. Znj. K shprehet se nëpërmjet komunikimit verbal nga punonjësit e kësaj Drejtorie i është komunikuar se duhet të jetë e regjistruar si punëkërkuese e papunë pranë Zyrës së Punës. Ajo ka pretenduar se edhe pse e ka paraqitur një dokument të tillë, sërish nuk i është marrë në konsideratë për t'u përjashtuar nga pagesa e tarifës së kopshtit.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Korçë, për përjashtimin nga pagesa për regjistrimin e fëmijës së saj në kopsht.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, mbështetur në kompetencën e parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *“racës”* dhe *“gjendjes civile”*, duke përcaktuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo*

shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Pas analizimit të ankesës nr. 207, datë 09.11.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të LMD-së, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 1555/1 prot., datë 15.11.2021 i është kërkuar informacion Bashkisë Korçë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

➤ Nëpërmjet shkresës me nr. 9748/1 prot., datë 26.11.2021, Bashkia Korçë solli parashtrimet e saj lidhur me problematikën e subjektit ankues, duke informuar ndër të tjera, se:

“Familja e ankueses përbëhet nga tre pjesëtarë: ajo, bashkëjetuesi dhe fëmija i tyre i mitur. Ata jetojnë në një banesë private, me hapësirë të mjaftueshme, në kushte të përshtatshme banimi. Në muajin nëntor të këtij viti, kanë paraqitur kërkesë pranë Zyrave të Kujdesit Social, pranë Bashkisë, për vazhdimin e pagesës së kopshtit të fëmijës së tyre, pasi të dy prindërit janë të papunë dhe nuk kanë mundësi për të kryer këtë pagesë”.

Bashkia ka informuar Komisionerin se, në kuadër të fuqizimit të familjes, Drejtoria e Kujdesit Social, pranë Bashkisë, zbaton një projekt për përjashtimin nga pagesa e kopshtit dhe çerdhes për fëmijët që vijnë nga familje me probleme social-ekonomike, të parashikuara në paketën fiskale, me objektiv kryesor fuqizimin e familjes dhe rritjen e kapaciteteve të prindërve për t’u kujdesur për fëmijët e tyre. Përfitues janë fëmijët e prindërve, të cilët janë të paaftë për punë, punëkërkues të papunë, të cilët tregohen bashkëpunues për të ndryshuar gjendjen e tyre ekonomike duke u punësuar ose duke ndjekur një kurs profesional, për krijimin e mundësive për punësim, si një faktor i rëndësishëm për sigurimin e një të ardhmeje më të mirë për fëmijët e tyre.

Bashkia Korçë, shprehet se: *“Familja Kosturi ishte e përfshirë në këtë projekt vitin e kaluar, për t’i lënë hapësirë që prindërit e fëmijës të përpiqen, nëse është e nevojshme, edhe me ndihmën tonë, të gjejnë një mundësi punësimi. Kur prindërit bëjnë përpjekje për të ndryshuar (brenda mundësive), duke u treguar bashkëpunues dhe reflektojnë për situatën në të cilën ndodhen, pagesa vazhdon edhe vitin pasardhës, ndoshta derisa fëmija të shkojë në shkollë.*

Familja Kosturi ka përfituar pagesën e vitit të kaluar, është orientuar drejt Zyrës së Punësimit dhe është orientuar drejt ndjekjes së një kursi profesional, dhe ka rezultuar se para disa ditësh, ankuesja është regjistruar si punëkërkuese e papunë, si dhe ka shprehur dëshirën për të ndjekur një kurs profesional. Rasti do të ndiqet në vijimësi”.

Bashkia ka informuar se, këtë vit akademik ka pasur një numër të konsiderueshëm të kërkesave për përfshirjen në këtë program, ku subjektet i drejtohen asaj me një dokument që tregon se vijnë nga pakicat, dhe se ky është një projekt që nuk vjen si shtesë e paketës së Ndihmës Ekonomike, apo në mbështetje vetëm të komunitetit rom dhe egjiptian. Projekti është i hapur për të gjitha familjet vulnerabel që bëjnë përpjekje për punësim ose që janë të gatshëm të punësohen në kuadër të fuqizimit të familjes, pavarësisht komuniteteve nga vijnë.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se pranë Bashkisë Korçë, gjatë vitit akademik 2018-2019 janë regjistruar dhe përjashtuar nga tarifa e pagesës së kopshtit dhe çerdhes 22 fëmijë, ku 16 nga këta i përkasin pakicave.

Në vitin 2020-2021 janë përjashtuar nga kjo tarifë 30 fëmijë, nga të cilët, 25 i përkasin pakicave. Këtë vit akademik, 2021-2022, deri aktualisht janë përfshirë në këtë projekt 9 fëmijë, nga të cilët 6 i përkasin pakicave.

Në vijim të procedurës hetimore lidhur me shqyrtimin e ankesës së znj. K, nëpërmjet e-mail-it⁴ të datës 20.12.2021, Komisioneri është informuar nga ana e Specialistes së Zyrës Rajonale Korçë/KMD, (*bashkëlidhur edhe aktet provuese*), se me datë 20.12.2021, ankuesja ka depozituar një deklaratë, nëpërmjet së cilës pohon se si rezultat i zgjidhjes së problematikës së saj, pas ndërmjetësimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Bashkinë Korçë, tërhiqet nga ankesa pranë KMD-së, pasi është arritur qëllimi për të cilin kishte paraqitur ankesën (*pagesa e kopshtit për fëmijën e ankuesit është mbuluar nga fondi i veçantë i Bashkisë Korçë*).

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e subjektit ankues është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të përfitimit nga përjashtimi i pagesës së regjistrimit të fëmijës së saj në kopsht.

Në këto kushte, Komisioneri gjykoj se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe, në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet: “*Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa*”, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon se:

⁴ Nëpërmjet deklaratës së subjektit ankues, nënshkruar para Specialistes së Drejtorisë së Pritjes së Ankesave të KMD-së / Zyra Rajonale Korçë.

“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur, lidhur me shqyrtimin e ankesës së subjektit ankues I. K, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Raca & gjendja civile
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti